

Lejet e ndërtimit

Tremujori IV, 2023

Tiranë, më 28 Shkurt 2024: Në tremujorin e katër 2023 janë miratuar gjithsej 303 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 415 leje të miratuara në tremujorin e katër 2022, duke shënuar një ulje prej 27,0 % (tab.2).


Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e katër 2023, është 592.660 m², nga 555.779 m² miratuar në tremujorin e katër 2022, duke shënuar një rritje prej 6,6 % (tab.3).

Në tremujorin e katër 2023, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 25,3 miliardë lekë, nga 26,6 miliardë lekë miratuar në tremujorin e katër 2022, duke shënuar një ulje prej 4,7 % (tab.4)

Gjatë vitit 2023, janë miratuar gjithsej 1.602 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 1.420 leje ndërtimi të miratuara në vitin 2022, duke shënuar një rritje prej 12,8 %.

Gjatë vitit 2023, sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja është 2.115.819 m², nga 2.667.497 m² miratuar në vitin 2022, duke shënuar një ulje prej 20,7 %. Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 89,6 miliardë lekë në vitin 2023, nga 113 miliardë lekë miratuar gjatë vitit 2022, duke shënuar një ulje prej 20,8 %.

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit, 2023



Tab.1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T4 - 2023

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej	303	592.660	22.410.267	2.905.844
I. Ndërtesa	303	592.660	22.118.182	1.426.123
1.Ndërtime për banim (rezidente)	232	453.534	16.119.880	229.154
a. Me një kat	82	10.815	352.209	44.477
b. Me dy kate	102	25.091	1.080.071	142.097
c. Me tre ose më shumë kate	28	164.914	5.832.042	22.599
d. Rezidenca për komunitetet	20	252.714	8.855.558	19.981
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	71	139.126	5.998.302	1.196.969
a. Hotele dhe të ngjashme	10	9.516	449.234	36.944
b. Ndërtesa për zyra	2	1.403	42.427	1.361
c. Ndërtesa tregtare	10	6.994	247.858	3.008
d. Ndërtesa industriale	30	50.286	1.710.214	57.946
e. Ndërtesa të tjera	19	70.927	3.548.569	1.097.710
II. Punime Inxhinierike			292.085	1.479.721
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			108.763	129.677
2. Linjat e ujësjellësave,elektrike dhe telekomunikacionit			28.959	860.873
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			0	0
4. Punime të tjera inxhinierike			154.363	489.171

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV-22	I - 23	II - 23	III - 23	IV - 23
Shqipëria	415	429	509	361	303
Berat	5	4	5	14	13
Dibër	3	2	4	3	2
Durrës	189	191	156	125	92
Elbasan	23	31	31	18	33
Fier	22	16	22	14	11
Gjirokastër	1	3	6	3	6
Korçë	34	38	42	43	25
Kukës	0	3	3	4	1
Lezhë	21	33	30	16	9
Shkodër	5	14	17	9	8
Tiranë	89	79	138	100	94
Vlorë	23	15	55	12	9

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 22	I - 23	II - 23	III - 23	IV - 23
Shqipëria	555.779	415.842	652.136	455.181	592.660
Berat	867	427	1.077	3.798	2.565
Dibër	1.632	1.469	1.978	1.958	3.507
Durrës	79.491	102.539	74.973	67.719	93.447
Elbasan	15.688	13.192	16.150	6.426	6.426
Fier	9.891	19.093	8.222	6.574	6.671
Gjirokastër	109	872	990	394	2.750
Korçë	24.955	12.207	10.826	22.622	17.220
Kukës	0	750	1.402	767	172
Lezhë	12.926	8.445	6.494	3.355	3.817
Shkodër	7.454	5.263	8.792	2.385	4.793
Tiranë	348.310	199.580	460.872	327.930	430.169
Vlorë	54.456	52.005	60.360	11.253	21.123

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Qarqet	IV - 22	I - 23	II - 23	III - 23	IV - 23
Shqipëria	26.572.383	20.967.072	24.407.672	18.930.632	25.316.111
Berat	257.249	138.428	108.760	377.074	147.523
Dibër	1.342.625	488.955	161.577	157.802	198.802
Durrës	2.691.797	3.659.070	1.974.254	3.252.489	4.472.832
Elbasan	3.830.507	1.312.126	883.773	268.445	438.726
Fier	816.833	625.861	826.504	461.810	1.478.155
Gjirokastër	12.170	250.620	255.450	74.786	458.208
Korçë	1.451.995	398.490	491.155	907.488	828.493
Kukës	11.936	212.265	259.170	47.493	15.659
Lezhë	909.183	488.218	233.245	132.372	108.950
Shkodër	253.444	186.017	77.750	225.448	199.480
Tiranë	12.156.725	6.564.046	16.072.582	12.189.452	16.118.918
Vlorë	2.837.919	6.642.976	3.063.452	835.973	850.365

Burimi: Bashkitë, Ilogaritjet INSTAT

* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstruksioneve.

Metodologjia

“Lejet e ndërtimit” është një publikim me frekuencë tremujore i cili ka për qëllim të paraqesë informacion mbi lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa dhe punimeve inxhinierike në nivel qarku dhe vendi. Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse.

Treguesit kryesorë të lejeve të ndërtimit të miratuara të cilat paraqiten në këtë publikim janë:

- Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

Punime Inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.